



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOŠOVA MINISTRI E AKSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr./Dr./No. 249	Nr. i faq./Dr. str./No. pg 1	
Data / Datum / Data: 07.02.2023 Pejë / Peë		

Këshilli Drejtues

Data: 06.02.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 03.02.2023, morri këtë:

VENDIM

- I. MIRATOHET Statuti i Institutit për Shkencë dhe Arte, në "Universitetin Haxhi Zeka", në Pejë.
- II. Këtij vendimi i bashkangjitet Statuti i Institutit për Kërkime dhe Arte, në "Universitetin Haxhi Zeka", në Pejë
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesuesës së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRITË E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKU" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Dc. / No.	249	Nr. / faq / Br. str / No. pg	9
Data / Datum / Date: 07.02.2023. Pejë / Peë			

STATUTI

I INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

PEJË, 2023

Mbështetur në nenin 11 të LIGJI Nr. 04/L-135 PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE-SHKENCORE, nenit 82, pika 2, e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Këshilli Drejtues UHZ –së , në mbledhjen e datës 03.02.2023, miratoi:

STATUTI I INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Instituti për Shkencë dhe Arte (*më tutje instituti*), në universitetin "Haxhi Zeka" ka për qëllim rritjen, përhapjen dhe mbrojtjen e shkencës; ai promovon dhe zbaton projekte kërkimore shkencore duke bashkëpunuar me akademi, universitete, organizata dhe Qendra Kërkimore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Fushëveprimi

Neni 2

Me këtë Statut rregullohet pozita dhe organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike në Universitetin "Haxhi Zeka", përkatësisht: planifikimi dhe realizimi i interesit të përgjithshëm në fushën e veprimtarisë kërkimore-shkencore e artistike, ofrimin e punës kërkimore-shkencore cilësore si dhe parimet e përgjithshme lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës, angazhimin në punë, organizimin dhe drejtimin me interes të përgjithshëm bazuar në kushtet për kryerjen e kësaj veprimtarie për arritjen e interesave të përgjithshëm, financimin e programeve me interes të përgjithshëm, si dhe çështjeve të tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarive kërkimore-shkencore e artistike.

Neni 3

Veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe artistike janë fusha me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe prosperitetin e Universitetit "Haxhi Zeka" (*në tekstin e mëtejshëm UHZ*), të bazuara në njohuri, dhe së bashku pjesën e mësimdhënies, konsiderohen faktorë shtytës kryesorë në zhvillimin akademik, ekonomik dhe atë të përgjithshëm shoqëror. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike, si fusha me rëndësi të veçantë për UHZ – në, janë të pandashme edhe me qasjen për bashkëpunim në hapësirat ndërkombëtare, shkencore, artistike, akademike dhe shoqërore. Instituti realizon edhe projekte shkencore hulumtuese të përbashkëta.

Veprimtaria e ISHA

Neni 4

Instituti kryen këto veprimtari:

- a) kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për avancimin e studentëve në sferën kërkimore-shkencore dhe artistike të cilat realizohen në UHZ;
- b) nxit veprimtarinë kërkimore-shkencore e artistike me qëllim të integritetit në hapësirën shkencore ndërkombëtare, rrënjosjen e parimeve të metodologjive shkencore dhe zhvillimin e njohurive të reja ndër brezat e rinj e të shoqërisë në përgjithësi;
- c) zhvillon aktivitetet për intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe artistike me institucionet tjera vendore dhe jashtë tij, në kuptim të zhvillimit të programeve hulumtuese të përbashkëta, kryerjen e studimeve dhe kërkimeve me karakter teorik, praktik e artistik nga fusha të ndryshme me interes të veçantë;

- d) motivon dhe përkrah tërë personelin e vet akademik për punë krijuese sistematike, me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, si dhe shfrytëzimit dhe zbatimit të këtyre rezultateve në praktikë;
- e) planifikon infrastrukturën e domosdoshme për veprimtari të mirëfilltë kërkimore-shkencore e artistike dhe ndërmerr aktivitete për zhvillimin e laboratorëve hulumtues;
- f) krijon bashkëpunime me Entin Statistikor të Kosovës dhe institucione të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit për t'i ardhur në ndihmë personelit akademik dhe studentëve me të dhëna nga fushat e interesit;
- g) kujdeset për pajisjen dhe funksionimin e mirëfilltë të bibliotekës shkencore;
- h) mbështetë veprimtarinë botuese shkencore;
- i) merret me vlerësimin e propozim-projekteve kërkimore-shkencore sipas kriterëve të përgjithshme për pranim të projektit;
- j) harton planin e aktiviteteve kërkimore-shkencore çdo vit kalendarik dhe analizon realizimin e tyre;
- k) vlerëson kompetencat profesionale – shkencore të realizuesve të projekteve dhe të punëtorëve të tjerë shkencorë të përfshirë në projekte;
- l) Mbështet industrinë dhe palët e interesuara në hulumtime specifike në fushat me interes për zhvillim shoqëror, ekonomik dhe fusha të tjera me interes të përbashkët;
- m) Zhvillon baza të të dhënave nga fushat e pesë njësive akademike të UHZ-së me qëllim të identifikimit, regjistrimit dhe ofrimit të zgjidhjeve shkencore në fushat përkatëse;
- n) vlerëson përmbushjen dhe respektimin e normave etike të projekteve shkencore të propozuara;
- o) inicion procedurat e aprovimit të hulumtimeve nga Odat e profesionistëve për lëmenjtë e shkencave shoqërore dhe artistike;
- p) merret me aktivitetet për realizimin e takimeve profesionale, simpoziumeve, konferencave, kongreseve, koncerteve, etj., si organizime vetanake;
- q) organizon punën e vazhdueshme të Shërbimit Informativ Shkencor (SHISH). SHISH së bashku me zyrën për informim në UHZ, në mënyrë sistematike, gjatë tërë viti kalendarik, bëjnë njoftimin e stafit akademik me agjendën e takimeve, konferencave dhe kongreseve, nacionale dhe internacionale të lëmenjve përkatës, në mënyrë që të përparojë veprimtarinë në fushën e publikimeve si dhe të informimit adekuat kërkimor-shkencor dhe artistike;
- r) Veprimtari komerciale brenda fushëveprimit së ISHA.

Neni 5

Instituti, në mënyrë të veçantë, bashkëpunon ngushtë me njësitë akademike dhe organizative në kuadër të UHZ –së, dhe vihet në shërbim të avancimit të veprimtarisë hulumtuese në institucione, ndërkaq për punën e vet i përgjigjet Këshillit drejtues të UHZ-së.

Organizimi dhe qeverisja

Neni 6

Organizimi i brendshëm i Institutit përcaktohet me këtë Statut.

Organet e ISHA

Neni 7

Organet e Institutit janë:

- 1) Këshilli Drejtues,
- 2) Këshilli Shkencor,
- 3) Drejtori i Institutit.

Këshilli drejtues

Neni 8

1. Këshilli drejtues është organ kolegjal i qeverisjes së Institutit.
2. Këshillin e përbëjnë:
 - 1) Rektori,
 - 2) Drejtori i Institutit,
 - 3) Përfaqësues nga pesë njësi akademike të miratuar nga Këshillat e fakulteteve.
Anëtarë i zgjedhur duhet të jetë së paku me thirrje akademike profesor asistent.
3. Këshillin drejtues e udhëheqë Rektori.
4. Mandati i anëtarëve nga ky nen pika 2.3 zgjatë 4 vite.

Detyrat e Këshillit Drejtues

Neni 9

Këshilli drejtues është organ qeverisës i Institutit i cili ka për detyrë:

1. Miratimin e planeve vjetore të punës së ISHA;
2. Hartimin e buxhetit vjetor të ISHA, dhe e dërgon për miratim në Këshillin drejtues të UHZ-së;
3. Hartimin dhe miratimin e rregullores për punën e këshillit;
4. Miratimin e planit strategjik të ISHA për 3 vite;
5. Monitorimin e zbatimit të planit strategjik të ISHA;
6. Të nxjerr raport gjashtëmuorësh të veprimtarisë së ISHA;
7. Miratimin e rregullave dhe udhëzuese për veprimtarinë e ISHA;
8. I propozon Këshillit drejtues të UHZ-së ndryshime në Statutin e ISHA;
9. Gjithçka tjetër që nuk mbulohet me detyrat e parapara për Këshillin shkencor dhe Drejtorin e institutit vendos Këshilli drejtues i ISHA.

Këshilli shkencor

Neni 10

1. Këshilli shkencor përbëhet nga:
 - 1) Prorektori për shkencë
 - 2) Prodekanët për shkencë të njësive akademike,
 - 3) Udhëheqësit e këshillave të fushave të veçanta shkencore (deri në 5 anëtarë),
 - 4) Këshilltarët shkencorë (deri në 5 anëtarë),
 - 5) Këshilltarë shkencorë të jashtëm (deri në 5 anëtarë)
2. Anëtarë të Këshillit shkencor mund të zgjidhen edhe punëtorë shkencorë të cilët nuk janë të punësuar në Institut, por janë të angazhuar në realizimin e projekteve shkencore.
3. Zgjedhjen e anëtarëve nga pika 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni bëhet nga Senati i UHZ-së.
4. Këshillin shkencor kryeson prorektori për shkencë.
5. Mandati i anëtarëve nga pika 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni zgjatë 4 vite, me mundësi të rizgjedhjes edhe një mandat.

Detyrat e Këshillit shkencor

Neni 11

1. Këshilli shkencor është organ profesional i Institutit që:
 - a) shqyrton dhe vendosë për veprimtarinë shkencore dhe artistike;
 - b) harton planin vjetor të punës së Institutit;
 - c) ndihmon hartimin e planit vjetor financiar;
 - d) miratojnë propozim-projektet hulumtuese të propozuara nga Këshillat e fushave shkencore dhe artistike;
 - e) përgatitë raportet e progresit në implementim të projekteve shkencore;
 - f) propozon alokimin e mjeteve për veprimtarinë kërkimore-shkencore, si dhe
 - g) kryen edhe punë të tjera në pajtim me këtë Statut;

Drejtori i Institutit

Neni 12

1. Drejtori i Institutit është organ drejtues në kryerjen e detyrave të veta në kuadër të kompetencave të përcaktuara me dispozitat e Statutit të këtij Instituti;
2. Për punën e tij/saj, i përgjigjet Këshillit drejtues të ISHA;
3. Mandati i Drejtorit është 4 vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat;
4. Drejtori i Institutit emërohet nga Këshilli drejtues i Institutit me propozim të Këshillit shkencor, pas procedurave transparente, dhe me meritokraci;
5. I njëjti mund të shkarkohet nga Këshilli drejtues me/pa propozimin e Këshillit shkencor të ISHA.

Arsyet e shkarkimit të drejtorit të ISHA

Neni 13

Arsyet e shkarkimit të drejtorit të ISHA:

1. Kur dënohet me aktgjykim të plotfuqishëm për veprën penale;
2. Për shkak të performancës së dobët e cila duhet të jetë e arsyetuar në raport me planin vjetor.

Detyrat e Drejtorit të ISHA

Neni 14

Drejtori i Institutit menaxhon dhe koordinon punët rreth kryerjes së veprimtarisë së Institutit dhe udhëheq punët e tilla, kujdeset për zbatimin e vendimeve të organeve qeverisëse dhe shkencore e artistike të Institutit, përfaqëson Institutin dhe kujdeset për ligjshmërinë në punët e Institutit dhe të organeve të tij.

Në kryerjen e këtyre funksioneve Drejtori i Institutit merret posaçërisht me këto punë:

- a) Udhëheq dhe organizon punën kërkimore-shkencore dhe artistike të Institutit;
- b) Harton projektin e planit dhe të programit për punën kërkimore-shkencore dhe artistike;
- c) Angazhon punëtorët në realizimin e plan-programit vjetor dhe afatgjatë dhe përgjigjet për realizimin me kohë të detyrave të parapara me plan dhe program;
- d) Orienton dhe koordinon punën e grupeve kërkimor-shkencore e artistike si dhe të individëve, qofshin këta punëtorë të Institutit apo bashkëpunëtorë të jashtëm të inkuadruar në realizimin e planit të Institutit;
- e) Shpjegon dhe arsyeton propozimet për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe kujdeset për ngritjen profesionale lidhur me projekte dhe punime të ndryshme;
- f) Merr pjesë në realizimin e detyrave kërkimore-shkencore dhe artistike të Institutit;
- g) Eshhtë përgjegjës për bashkëpunim me institucione dhe individë të jashtëm në kuadër të punës së Institutit;
- h) Organizon punën shkencore, profesionale dhe artistike në kuadër të veprimtarisë dhe të aktiviteteve të përcaktuara me program dhe plane të punës;
- i) Kujdeset për përparimin e metodave në punë dhe propozon masat për përparimin e punës dhe të veprimtarisë së Institutit si dhe popullarizimin e kësaj veprimtarie;
- j) Merr masa për zhvillimin e bashkëpunimit me institucione të ngjashme në vend dhe jashtë vendit;
- k) Kujdeset për aftësimin e kadrove shkencore dhe profesionale;
- l) Kujdeset që puna materiale-financiare të zhvillohet në bazë të dispozitave të akteve normative të UHZ –së dhe të Institutit;
- m) Merr pjesë në mbledhjet (tubimet) e organeve udhëheqëse të UHZ –së, njërive akademike të saj dhe të Institutit;
- n) Lidh dhe nënshkruan kontrata në emër të Institutit në koordinim me Këshillin drejtues të ISHA, për çështje të aprovuara në buxhetin vjetor;
- o) Përfaqëson Institutin para gjykatave, organeve apo personave të tretë;

- p) Vendos për përdorimin dhe shpenzimin e mjeteve që ka Instituti deri në shumën e caktuar nga Këshilli Drejtues dhe sipas autorizimit të Rektorit;
- q) I raporton rregullisht organeve të Institutit lidhur me punën, realizimin e programeve dhe të planeve të punës së Institutit ose lidhur me problemet e ndryshme të Institutit;
- r) Tërheq vërejtjen dhe jep opinione lidhur me ligjshmërinë e vendimeve;
- s) Merr masa lidhur me mbrojtjen e ligjshmërisë në punën e Institutit;
- t) Në kuadër të akteve normative të Institutit dhe të vendimeve të UHZ, jep urdhëresa me qëllim të realizimit me sukses të veprimtarisë së Institutit;
- u) Analizon problemet e Institutit dhe paraqet raport mbi gjendjen e konstatuar;
- v) Ushtron edhe të drejtat dhe detyra të tjera, të parapara me akte normative të Universitetit dhe të Institutit.

Neni 15

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike e Institutit është e organizuar nëpërmjet njësive akademike të UHZ-së të përfaqësuara në Institut:

- 1) Njësia e Institutit – Fakulteti i Biznesit;
- 2) Njësia e Institutit – Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelërisë dhe Mjedisit;
- 3) Njësia e Institutit – Fakulteti Juridik;
- 4) Njësia e Institutit – Fakulteti i Agrobiznesit;
- 5) Njësia e Institutit – Fakulteti i Arteve;

Neni 16

1. Punën e njësive të veçanta të Institutit e koordinon prodekani për shkencë i secilës njësi të veçantë.
2. Njësitë e Instituteve kanë nga 3 anëtarë, të emëruar nga Këshilli i fakultetit;
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre anëtarëve përcaktohen me rregullore të veçantë të hartuar nga Këshilli shkencor.

Neni 17

Fushat me të cilat merren njësitë e institutit janë:

- 1) Shkencat e biznesit, ekonomisë, financave dhe teknologjisë informative;
- 2) shkencat e turizmit dhe hotelërisë;
- 3) shkencat e drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- 4) shkencat e agrobiznesit dhe mjedisit;
- 5) shkencat artistike –muzikore.

Këshilli shkencor mund të përcaktojë edhe fusha të tjera shkencore, sipas nevojës.

Neni 18

1. Veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike të Institutit e zhvillojnë punonjësit shkencorë me tituj shkencorë.
2. Me punë kërkimore-shkencore dhe artistike, krahas punëtorëve shkencorë, merren edhe hulumtuesit. Përveç punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, punën kërkimore-shkencore në Institut e ushtrojnë edhe mësimitdhënësit e zgjedhur në tituj shkencorë-mësimitdhënës.

Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit

Neni 19

1. Për organizimin e punës në Institut, caktohen vendet e punës. Me vendin e punës nënkuptohet një sërë punësh, respektivisht detyrash të punës në kuadër të veprimtarisë punonjëse në Institut ku punon një ose më shumë punëtorë. Secili vend i punës ka emrin

përkatës. Emri i vendit të punës caktohet varësisht prej veprimtarisë, llojit të punës dhe detyrave të punës.

2. Këshilli Drejtues i Institutit nxjerrë rregullore të veçantë për sistematizimin e vendeve të punës dhe përshkrimin e detyrave të punës në Institut.

Neni 20

1. Secili vend i punës duhet të përfshijë punët dhe detyrat e punës që duhet të kryhen në atë vend pune.

Neni 21

1. Titujt shkencorë dhe hulumtues janë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore dhe artistike.

Sipas këtij ligji, titujt të tillë janë:

1) Titujt shkencorë:

- 1.1. Bashkëpunëtor shkencor;
- 1.2. Bashkëpunëtor i lartë shkencor; dhe
- 1.3. Këshilltar shkencor

2) Titujt hulumtues:

- 2.1. Hulumtues shkencor; dhe
- 2.2. Hulumtues i pavarur shkencor.

2. Këshilli shkencor i ISHA i propozon Senatit të UHZ-së për miratim rregulloren për emërim/riemërimin dhe procedurat e rekrutimit të personelit sipas pikës 1 të këtij neni.

Bashkëpunëtori shkencor

Neni 22

Bashkëpunëtori shkencor duhet të jetë doktor i shkencave dhe të ketë punime të vlerësuara shkencore.

Bashkëpunëtori i lartë shkencor

Neni 23

Bashkëpunëtori i lartë shkencor duhet të jetë doktoruar nga lëmi përkatëse, të ketë punime shkencore të botuara, të cilat janë të vlerësuara si kontribut shkencor.

Këshilltari shkencor

Neni 24

Këshilltari shkencor duhet të jetë doktor i shkencave, duhet të ketë arritur një shkallë të lartë të pjekurisë shkencore që dëshmohet përmes veprave të botuara me rëndësi të veçantë për Institutin me të cilën mirëet.

Hulumtuesi shkencor

Neni 25

Kandidati duhet të ketë kryer fakultetin në nivelin bachelor, të ketë të regjistruar studimet e masterit, të ketë punime profesionale e shkencore të vlerësuara pozitivisht.

Hulumtuesi i pavarur shkencor

Neni 26

Kandidati hulumtues i pavarur shkencor duhet të ketë të përfunduar masterin, si dhe të ketë të publikuara punime profesionale-shkencore të vlerësuara pozitivisht.

Bashkëpunëtorët
Neni 27

Vendi i punës:

- 1) bashkëpunëtor i lartë shkencor,**
- 2) bashkëpunëtor shkencor,**
- 3) hulumtues i pavarur dhe hulumtues shkencor**

Vende të punës mund të plotësohen nga kuadri i rregullt mësimor i UHZ.

Rizgjedhjes i nënshtrohen:

- i. bashkëpunëtori i lartë shkencor dhe bashkëpunëtori shkencor, çdo pesë vjet, ndërkaq
- ii. hulumtuesi i pavarur dhe hulumtuesi çdo tre vjet.

Personat e zgjedhur si më sipër, nëse i plotësojnë kushte e parapara më Statutin e UHZ –së, mund të angazhohen në mësimdhënie në njësitë e UHZ, pa pasur nevojë për procedura konkursi.

Personeli teknik – administrativë
Neni 28

1. Instituti, ka personelin e tij tekniko-administrativ.
2. Shërbimi tekniko-administrativ i Institutit përbëhet nga:
 - 1) Sekretari i Institutit,
 - 2) Bibliotekisti,
 - 3) Arkivisti për punë shkencore,
 - 4) Zyrtari për shërbimin informativ-shkencor dhe
 - 5) Asistenti administrativ.
3. Shërbimet teknike dhe administrative, i kryejnë personalitë e administratës së UHZ –së për të cilët, nëse është e lejuar me ligj, mund të parashihet një kompensim shtesë.
4. Kompensimi dhe procedura e angazhimit bëhen në harmoni me ligjin në fuqi.
5. Infrastruktura e punës të cilën e shfrytëzon ISHA, duke përfshirë shërbimet e administratës së UHZ, punonjësit e Institutit si dhe sistematizimi i vendeve të punës, përcaktohen dhe rregullohen me Rregulloren e punës së Institutit së bashku me asistencën e menaxhmentit të lartë të UHZ –së.

Neni 29

1. Biblioteka shkencore është pjesë përbërëse e Bibliotekës së UHZ, në të cilën do të vendosen botime dhe punime të dala nga aktivitetet e ISHA;
2. Të gjitha shërbimet e Bibliotekës së UHZ-së janë në dispozicion të ISHA.

FINANCIMI
Neni 30

Instituti veprimtarinë e vet kërkimore-shkencore dhe artistike e realizon nëpërmjet mjeteve financiare të siguruara nga:

- a) fondet vetanake të ISHA;
- b) mjetet që i realizon Instituti, me shërbimet komerciale shkencore dhe artistike;
- c) fondacionet dhe donacionet tjera alternative të ligjshme;
- d) mjetet e buxhetit të MASHTI-it të destinuar për UHZ-në e të ndara për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike, përkatësisht të projekteve për të cilat MASHTI-i shpall konkurs;
- e) grande të jashtme për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike;
- f) burime të tjera të ligjshme.

Neni 31

1. UHZ çdo vit kalendarik përcakton vlerën e mjeteve vetanake, si buxhet inicial i Institutit për përmbushjen e veprimtarisë së vet për atë vit kalendarik.
2. Buxheti i institutit, gjegjësisht të gjitha të hyrat dhe të dalat nga puna dhe aktiviteti i tij transferohen nëpërmjet buxhetit të UHZ-së konform ligjit në fuqi.
3. Shuma dhe normat e pagesave të stafit dhe të hulumtuesve për projekte të realizuara, duke i përfshirë edhe kostot për shfrytëzimin e burimeve të UHZ –së, rregullohen me Rregullore të veçantë e cila miratohet nga Këshilli drejtues i ISHA.

Neni 32

Çdo vit kalendarik Instituti e përpilon listën e shërbimeve komerciale, shkencore dhe artistike që i ofron institucioneve të tjera, të cilën e publikon në faqen zyrtare të Institutit për vitin kalendarik përkatës.

Neni 33

Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve të siguruara nga neni 29, paragrafi 1, pika a, b, c, d, e dhe f, përcaktohen në mënyrë të veçantë me Rregullore të veçantë.

Neni 34

Çdo gjë që nuk është përcaktuar me këtë statut, vlejné dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore, Ligjit për arsimin e lartë Nr. 04/L-037 dhe Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

II. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Me këtë Statut shfuqizohen të gjitha Rregulloret paraprake që i rregullojnë këto çështje.

Neni 36

1. Për zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti kujdeset Këshilli Drejtues i ISHA.
2. Statuti hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të UHZ –së.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

